

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Në çështjen juridike të :****AC-I-22-0210-A0001***Paditësi/Ankuesi***M M**, me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin B I, Prishtinë**Kundër:***E paditura***N.SH. “Magjistrala”,** (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1818, të datës 17 mars 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 janar 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1818, i datës 17 mars 2022 dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0232 i datës 5 qershor 2013.
3. Obligohet e paditura që në emër të pagave të papaguara për periudhën nga janar-mars 2006, t'i paguaj paditësit shumën prej 1,078.89 euro, interesin ligjor prej 10% në shumën prej 107.88 euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumën prej 104.00 euro si dhe taksën gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.
4. Pjesa e mbetur e kërkesës në shumën prej 3,236.67, refuzohet si e pabazuar.
5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 10 korrik 2013, në DHPGJS-së ishte parashtruar një padi grimore prej 142 punëtorëve ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit të së paditurës N.SH “Magjistrala” (në likuidim), me të cilat vendime ishin refuzuar kërkesat e punëtorëve të parashtruara para Autoritetit të Likuidimit, e cila lëndë kishte numrin C-IV-13-1216 por që me urdhrin e lëshuar nga gjyqtari i çështjes i DHPGJS-së, i datës 27 nëntor 2013, për ndarjen e padisë, kjo çështje kishte marrë numrin C-IV-15-1818.

Me datë 30 shtator 2015, paditësi kishte parashtruar një padi në DHPGJS sipas urdhrin të lëshuar nga gjyqtari i çështjes, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0232 të datës 5 qershor 2013, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 4,315.56 euro ishte pranuar si e bazuar në shumën prej 173.05 euro (20% e pagës), ndërsa ishte refuzuar si e pabazuar në shumën prej 4,142.51 euro. Kjo për faktin se sipas konstatimit të AL-së kjo shumë përbën vlerën neto të pagueshme ndaj kërkuarit pasi që pjesa e tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributi pensional janë mbajtur në momentin e pagesës së vlerës së 80% të rrogës.

Në ankesë theksohet se e paditura nuk e kishte kontestuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënie të rregullt dhe të përhershme të punës në ndërmarrjen në fjalë e kjo sigurisht për arsye se ekziston dokumentacion i mjaftueshëm i cili dëshmon se paditësi ishte në punë te e paditura dhe kjo e fundit ishte e obliguar t’i paguante atij të gjitha pagat e papaguara deri në ditën e privatizimit të N.SH-së. Tutje, paditësi thekson se nuk është Banka Ekonomike institucioni që i lëshon dhe ruan-mban listat e pagave të punëtorëve, prandaj llogaritë bankare të paditësve dhe historiku i tyre dëshmon vetëm pagesat e bëra nga N.SH-ja paditësit. Pikërisht nga lista e pagave shihet se paditësit i ka mbetur borxh N.SH-ja dhe kjo dëshmohet nga lista e pagave mujore duke filluar nga muaji tetor-dhjetor 2005 dhe janar-mars 2006, të cilat lista specifikojnë në mënyrë të qartë titullarin dhe lartësinë e pagës. Gjithashtu, paditësi thekson se i njëjti është në listën e 20% që tregon se ai ishte i regjistruar në N.SH si punëtor aktiv deri në ditën e privatizimit. Provat dhe dokumentacionin lidhur me marrëdhënien e punës në ndërmarrjen në fjalë sipas Ligjit të AKP-së është i detyruar t’i mbaj dhe ruaj punëdhënësi (e paditura) që parashihet me nenin 5.5 të Politikave Operacionale të AKP-së. Andaj, gjykatës i

kishte propozuar që të miratohet padia e paditësit dhe të anulohet vendimi i të paditurës, ashtu që AKP t'i paguaj paditësit në emër të pagave të papaguara shumë prej 4,315.56 euro, kamatën e bazuar në ligj-kamatë për vonesë në shkallën prej 3.5 % që rrjedh nga data 1 janar 2008 deri më 19 dhjetor 2012 dhe kamatën prej 8% nga kjo datë deri në ditën e pagesës së plotë si dhe shpenzimet e përfaqësimit dhe të tjera deri në fund të procedurës.

Paditësi si prova kishte bashkëngjitur: autorizimin për përfaqësim, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0232 të datës 5 qershor 2013, kontratën e punës ndërmjet N.SH-së dhe paditësit, kopjen e librezës së punës si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Me datë 7 mars 2022, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën thekson se parashtruesi nuk ka identifikuar se cili nen konkret i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit gjatë marrjes së vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 70.2 të Ligjit 03/L-033 që parashikon se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP. Autoriteti i Likuidimit dëshiron të theksoj se me datë 23 maj 2013, Banka Ekonomike e përfaqësuar nga I A në cilësinë e tij si Drejtor Ekzekutiv kishte dorëzuar pranë AKP-së përgjigjen bashkë me historikun e llogarisë së klientit për periudhën e kërkuar nga e cila rezulton se parashtruesi i kërkesës ka punuar orë efektive në punë në N.SH në muajt tetor-mars 2006 dhe është paguar për këta muaj në masën 80% të pagës së tij neto, përveç muajit shkurt 2006 për të cilin është paguar në masën 100% neto. AL e konsideron kërkesën në fjalë si pjesërisht të vlefshme dhe si rrjedhojë e aprovon për shumë 173.05 euro (20% e pagës). Kjo shumë e përbën vlerën neto të pagueshme ndaj kërkuesit pasi pjesa e tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributi pensional janë mbajtur në momentin e pagesës së vlerës së 80% të rrogës. Andaj, e paditura i kishte propozuar gjykatës të refuzohet ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 17 mars 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1818 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vërtetuar vendimin e Autoritetit të

Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe parashtrimet e palëve në procedurë dhe ka konstatuar se N.SH në fjalë ka hyrë në procedurën e likuidimit me datë 28 qershor 2007 dhe parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesë për kompensimin e shumës prej 4,315.56 euro. AL kishte kërkuar informacione nga Banka Ekonomike në lidhje me historikun e llogarisë së klientit për periudhën janar 2006 deri në dhjetor 2007 dhe ka rezultuar se parashtruesi i ankesës ka punuar në ndërmarrje dhe është paguar për periudhën tetor-dhjetor 2005, janar-mars 2006 në masën prej 80%, ndërsa për muajin shkurt 2006 është kompensuar në vlerën prej 100% të pagës. Kompensimi i pagave është rregulluar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në mbi prioritetet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6, pika 1.6.1 që parashihet “kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuara në tri paga mujore bruto për person”. Gjykata kishte ardhur në përfundim se paditësi nuk ka parashtruar prova të cilat do të dëshmonin se i njëjti nuk është kompensuar për periudhën kontestuese, andaj duke u nisur nga parimi i barrës së provës, në kuptim të dispozitës së nenit 322.1 të LPK-së gjykata ka ardhur në përfundim se pala paditëse me provat e prezantuara nuk ka mundur që t’i argumentoj pretendimet e dhëna me padi, rrjedhimisht edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me datë 14 prill 2022, ankuesi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit të shkallës së parë C-IV-15-1818 të datës 17 mars 2022, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të miratoj ankesën e ankuesit, ndërsa të obligohet AKP që në emër të pagave të papaguara t’i paguaj shumën prej 4,315.56 euro me kamatë ligjore dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit. Në ankesë theksohet se aktgjykimi i ankimuar është plotësisht kontradiktor në vetvete përderisa në aktgjykim thuhet se paditësi nuk ka ofruar dëshmi kur fillimisht kishte pranuar se palët kanë dorëzuar provat. Tutje, thekson se vlerësimi i gjykatës se paditësi nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të provonte që gjatë periudhës janar-dhjetor 2006 ka kryer punët sipas përshkrimit të vendit të punës, nuk ka asnjë bazë ose gjykata fare nuk e ka shfletuar dosjen e paditësit ose lista e pagave që i është dorëzuar gjykatës të paktën tre herë. Gjykata ka

mundësi që fare nuk e ka shikuar vendimin e AL-së përndryshe si është e mundur që kur flet për këtë vendim konstaton përmbajtje të cilat vendimi i AL-së nuk i ka. Tutje, konsideron se nuk është Banka institucioni që i lëshon e as i ruan-mban listat e pagave të punëtorëve, prandaj llogaritë bankare të paditësve dhe historiku i tyre dëshmon vetëm pagesat e bëra nga N.SH-ja. Pikërisht nga lista e pagave shihet që paditësit i ka mbetur borxh N.SH-ja dhe kjo dëshmohet nga lista e pagave mujore duke filluar nga muaji janar 2006 deri në dhjetor 2006. këto lista specifikojnë në mënyrë të qartë titullarin dhe lartësinë e pagës. Ankesës i kishte bashkëngjitur: kopjen e librezës së punës së paditësit, listën e pagave për muajin janar-dhjetor 2006, regjistrin e punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjatë punës në SHA “Magjistrala”, një deklaratë nën betim e Sh P dhe A K, kopjet e letërnjoftimit të Sh P dhe A K, një kontratë punë të lidhur ndërmjet SHA “Magjistrala” si dhe Sh P, Aktvendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së punëtorit të SHA “Magjistrala”, S H, i datës 21 qershor 2007 si dhe një referencë për Sh P e datës 25 maj 2007.

Me datë 21 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesë në të cilën thekson se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura, andaj propozon që apeli të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS si dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0232 i datës 5 qershor 2013, lidhur me kërkesën e paditësit për dëmshpërblim për paga të papaguara në shumën prej 4,315.56 euro për periudhën tetor-dhjetor 2005 dhe janar-mars 2006 dhe ankesa e paditësit aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për paga të papaguara për shumën dhe periudhën e lartcekur ishte aprovuar në shumën prej 173.05 euro dhe ishte refuzuar në shumën prej 4,142.51 euro, me arsyetim se ishte paguar në vlerën prej 80% për tetor-dhjetor 2005.

Paditësi në shkallë të parë kishte dorëzuar si prova: autorizimin për përfaqësim, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN032-0232 të datës 5 qershor 2013, kontratën e punës ndërmjet N.SH-së dhe paditësit, kopjen e librezës së punës si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Me Aktgjykimin e shkallës së parë C-IV-15-1818 të datës 17 mars 2022, kërkesa e paditësit ishte refuzuar si e pabazuar, duke vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit pasi që gjykata kishte vlerësuar se paditësi nuk ka parashtuar prova të cilat do të dëshmonin se i njëjti nuk është kompensuar për periudhën kontestuese.

Paditësi në ankesën e tij në shkallë të dytë kishte vazhduar të kërkoj kompensimin e pagave të papaguara në shumën e lartcekur si dhe kishte bashkëngjitur si prova: kopjen e librezës së punës së paditësit, listën e pagave për muajin janar-dhjetor 2006 dhe regjistrin e punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjatë punës në SHA “Magjistrala”.

Në këtë rast Kolegji i Apelit vendosi t’i pranoj këto prova në interes të drejtësisë.

Nga provat e bashkëngjitura, të cekura si më lartë, përkatësisht nga kopja e librezës së punës shihet qartë se paditësi kishte ofruar shërbime për N.SH deri në ditën e privatizimit të saj dhe se të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat këtij privatizimi me datë 13 prill 2007.

Gjithashtu, nga listat e pagave të dorëzuara nga paditësi për periudhën për të cilën i kërkon pagat e papaguara, shihet që N.SH për muajt janar-mars 2006 i kishte mbetur borxh paditësit shumën prej 1,078.89 euro, me pagë mujore 359.63 euro, e cila shumë duhet t’i paguhet paditësit nga Autoriteti i Likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit.

Sa i përket shumës së mbetur të kërkuar nga paditësi prej 3,236.67 euro, Kolegji i Apelit konsideron se duhet të refuzohet për faktin se nuk është e mbështetur në prova dhe argumente.

Kjo për faktin se paditësi kishte dorëzuar listat e pagave si provë për muajt janar-dhjetor 2006, mirëpo i njëjti para Autoritetit të Likuidimit dhe ne padi në DHPGJS-ë kishte kërkuar pagat për muajt tetor-dhjetor 2005 dhe janar-mars 2006, por jo për muajt tetor deri në dhjetor nuk 2006 siç kërkon në ankesë në shkallë të dytë. Një kërkesë të tillë e cila nuk ishte objekt i kërkesës në shkallë të parë nuk mund të jetë as para Kolegjit të Apelit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi përveç borxhit kryesor ka kërkuar edhe interesin ligjore. Bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, paditëses i njihet edhe e drejta në interesin ligjor prej 10% ose në shumën 107.88 euro e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Pasi që pala e paditur është palë e pasuksesshme në këtë lëndë, bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, paditëses i njihet edhe e drejta në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore lidhur me përfaqësimin nga ana e avokatit në shumë prej 104.00 euro vetëm për ankesën në shkallë të dytë si dhe taksën gjyqësore prej 20 euro, pasi që ankesa e paditësit aprovohet vetëm pjesërisht dhe jo në tërësi, që po ashtu do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_